

KRU Hidrodrini Sh.A.

**Pasqyrat financiare më dhe për
vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe
Raporti i Auditorit të Pavarur**

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	-
Deklarata e Pajtueshmërisë	-
Pasqyra e Pozitës Financiare	1
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimit në Ekuitet	3
Pasqyra e Rjedhës së Parasë	4
Shënimet në pasqyrat financiare	5 - 16



**Nexia
KS**

Audit • Tax • Advisory

Nexia KS shpk | Str. Xhevdet Doda,
Hyrja B, Kati 14, B1, Prishtinë, Kosova
D: +383 49 882 587 | T: +383 49 974 293
E: info@nexia-ks.com
W: nexia-ks.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Shoqërisë

20 prill 2022

Opinionin ynë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të KRU Hidrodrini SH.A. "Shoqëria" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshëm të çështjeve të përshkruara në seksionin baza për opinion të kualifikuar në raportit tonë, pasqyrat financiare individuale paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar (SNRF).

Bazat për Opinion të kualifikuar

1. Shoqëria ka njohur një rezervë të rivlerësimit prej EUR 21,744,554 (31 Dhjetor 2020: EUR 21,744,554) që është njohur në bazë të raportit të vlerësimit të kryer në vitin 2007. Që nga koha e vlerësimit deri me datë të raportimit të pasqyrave financiare nuk është bere rishikimi të vlerës të vlerësimit dhe as rivlerësim edhe pse ka kaluar nje periudhe prej 13 vite nga data e vlerësimit, duke marr per baza qe gjendja ekonomike te ndërmarrjes dhe po ashtu edhe kushtet e tregut kan ndryshuar nga data e vlerësimit. SNRF dhe SNK përkatëse kerkojne qe ne rast qe asetet mbahen me vlerën e drejt te tregut te behet rishikim vazhdushem i vleres se drejt te pasurive dhe po ashtu pas disa peridha te merret ne konsiderat nevoja per te bere rivlerësimi pasurive qe mbahen me vlere te drejt te tregut.

Per me teper, per tokat e prezentuara si pasuri te kompanise ne shume prej EUR 2,304,350, ne baze te dokumenteve te pronesise te ofruara nuk jane ne pronesi te KRU Hidrodrini.

2. Sic është shpalosur në Shënimin 7 të pasqyrave financiare, llogaritë e arkëtueshme janë EUR 11,493,753 (31 dhjetor 2020: EUR 12,414,863) neto nga provizionet për borxhe të këqija. Nje shume e konsiderueshme nga ky provizion ishte njohur viteve të mëparshme, ndërsa për vitin 2021 respektivisht 2020, Shoqëria ka bërë një vlerësim të pjesërishëm të provizionit duke u bazuar vetëm në ditë vonesa sipas grupeve. Në nuk ishim në gjendje për të vlerësuar nëse do të kishte qenë e nevojshme provizionim shtesë në llogaritë e arkëtueshme dhe në çfarë niveli si pasojë e mungesës së informacionit adekuat si rezultat te mos mbeshtetje me informacion nga softueri i perdorur. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të vertetojmë nëse Shoqëria do jetë në gjendje të inkasojë vlerën e llogarive të arkëtueshme të prezentuara. Shoqëria nuk ka analiza të mjaftueshme të cilat mbështësin parashikimet e menaxhmentit të bëra në relacion me balancën e provizionit të borxheve të këqija dhe të dyshimta. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2021. Përmëtepër, shoqëria nuk ka aplikuar në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në lidhje me provizionimet e llogarive të arkëtueshme. Ne mungesë të analizave historike të kërkuar nga SNRF 9, për kalkulimin e provizioneve në llogarit e arkëtueshme në nuk mund të vlerësojmë se sa do mund të jetë efekti në provizionim nëse do përfillin në tërësi kërkesat që dalin nga SNRF 9 në kalkulimin e provizionit.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve dhe kërkesave janë përshkruar më tej në seksionit raportit tonë për përgjegjësi të e auditorit për auditimin e të pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur për kompanin në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve' Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike të / L-032 Ligji Nr 6 (për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të cilat janë relevante Auditimi ynë i pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështje kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tone profesional, ishin me të rëndësishmet ne auditimin tone të pasqyrave financiare individual të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan ne kontekstin e auditimit tone të pasqyrave financiare në tërësi, dhe ne formimin e opinionit tone mbi ato, dhe ne nuk japim një opinion të veçante për këto çështje. Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar, ne nuk kemi përcaktuar çështjet të tjera si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë të auditimit.

Çështje të tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin e përfshirë në raportin menaxhmentit, informacione të cilat nuk janë të pasqyra financiare të shoqërisë.

Mendimi ynë për pasqyrat financiare individuale nuk përfshin informacionin tjetër dhe nuk shprehim asnjë formë të përfundimit të sigurimit mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, përgjegjësia jonë është që lexoni informacionin tjetër dhe, duke bërë këtë, merrni parasysh nëse informacioni tjetër nuk është material në kundërshtim me pasqyrat financiare të individual ose duke u bazuar në njohuritë tona të marra në auditim ose në të kundërt duket se janë gabim materiale. Bazuar në punën që kemi kryer, konstatojmë se nuk ekziston një gabim material i këtij informacioni tjetër, ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe të Ngarkuarit me Qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar në vijimësi, shpalosjen, sipas rastit, çështjet që lidhen me vazhdimin në vijimësi dhe duke përdorur bazën kontabilitetit për vazhdimin në vijimësi, përveç nëse Menaxhmenti ose synon të likuideojë kompaninë ose të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste, përpos për ta bërë këtë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale kur ajo ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një pasaktësie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se për një pasaktësi që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë,

falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje e kontrolleve të brendshme.

- Marrim një kuptim të kontrolleve të brendshme relevante për auditimin me qëllim hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Kolaudojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Menaxhmentit të bazës së kontabilitetit për të vazhduar në vijimësi dhe në bazë të dëshmive të marra të auditimit, dhe nëse një pasiguri material ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri material ekziston, ne jemi të detyruar për të tërhequr vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj shpalosjeve të lidhura në pasqyrat financiare ose, nëse shpalosjet e tilla janë të pamjaftueshme, për të modifikuar opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në prova të auditimit të marra të deri në datën e Raportit të Auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompanisë të ndërpres së qeni sipas bazës së vazhdimin në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në një mënyrë që arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me të ngarkuarit me qeverisje në lidhje me, mes çështjeve të tjera, shtrirjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu sigurojmë të ngarkuarit me qeverisje me një deklaratë që jemi në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe për të komunikuar me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështje të tjera që me arsye mund të mendohet të bien në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masa mbrojtëse të lidhura.

Nga çështjet komunikuar me të ngarkuarit me qeverisje, kemi përcaktojmë ato çështje që janë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Ne përshkruajmë këto çështje në raportin e auditorit përveç kur ligji apo rregullorja e pengon zbulimin publik në lidhje me këtë çështje, ose kur, në rrethana shumë të rralla, përcaktojmë që një çështje e nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat negative e të bërit këtë në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të peshoj më shumë përfitimet e interesit publik nga komunikimi i tillë.

Raporti mbi kërkesat tjera ligjore dhe rregullative

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të shoqërisë Hidrodrini SH.A., si dhe informacionin e shkruar në raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të

përcaktuara tek neni 10 ne ligjin Nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Sipas mendimit tonë raporti i menaxhmentit është ne përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur ne përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiare dhe auditim neni 7, dhe te udhëzimit administrative Nr. 07/2019 për Struktura, Përmbajtjen dhe Dorëzimin e Raporteve Financiare.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga organizata në përputhje me Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Kontabilistëve të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë (Kodit IESBA) dhe te kërkesave te ligjit nr.06/L-032, ne i kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA dhe kërkesat ligjore qe dalin nga ligji Nr.06/L-032 dhe nga Udhëzimi Administrative nr. 02/2019.

Ne nuk kemi ofruar shërbime te tjera tek organizata te cilat janë te përcaktuar me Udhëzimi Administrative nr.02/2019.

Xhevdet Beqiri,
Auditor Ligjor



Nexia KS Sh.p.k

Str. Xhevdet Doda,
Hyrja B, Kati 14, B1
10000, Prishtinë,
Kosovë
29 prill 2022

Nexia KS Sh.p.k

Logo e kompanisë

Deklarata e pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare të shoqërisë KRU Hidrodrini Sh.A. që përfundojnë me datë 31 dhjetor 2021.

Menaxhmenti i shoqërisë (Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtori Financiar) deklarojnë që pasqyrat financiare të shoqërisë KRU Hidrodrini Sh.A. të cilat përfundojnë me datë 31 dhjetor 2021 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhës së parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për NVM dhe kërkesave ligjore dhe në veçanti me kërkesat e Ligjit Nr.06/L-32 për “Kontabilitet, Raportim financiar dhe auditim”.


Agron Tigani
Drejtor Ekzekutiv



(Prishtinë, 19 prill 2022)


Rasim Maloku
Drejtor Financiar


KRU Hidrodrini Sh.A.


Pasqyra e Pozitës Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

(Shumat në Euro)

		<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
	Shënimi		
Pasuritë			
Pasuritë jo-rrjedhëse			
Toka, prona dhe pajisjet		14,294,863	15,664,401
Investimet në vijim		22,035,080	16,132,439
Gjithsej pasuritë jo-rrjedhëse	4	<u>36,329,942</u>	<u>31,796,840</u>
Pasurite rrjedhëse			
Stoqet	5	509,808	509,590
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	6	11,493,753	12,531,139
Parapagimet dhe kërkesat tjera	7	315,290	302,568
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	7,214,616	6,061,074
Gjithsej pasuritë rrjedhëse		<u>19,533,467</u>	<u>19,404,371</u>
Gjithsej pasuritë		<u>55,863,410</u>	<u>51,201,211</u>
Ekuiteti dhe detyrimet			
Kapitali aksionar		25,000	25,000
Rezervat tjera		21,744,554	21,744,554
Humbja e bartur		(348,952)	(795,945)
Gjithsej ekuiteti		<u>21,420,602</u>	<u>20,973,609</u>
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Të hyrat e shtyra	9	30,831,257	27,575,337
Gjithsej detyrime jo-rrjedhëse		<u>30,831,257</u>	<u>27,575,337</u>
Detyrimet rrjedhëse			
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	10	1,577,379	377,715
Detyrimet tatimore	11	2,034,172	2,274,550
Gjithsej detyrimet rrjedhëse		<u>3,611,551</u>	<u>2,652,265</u>
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		<u>55,863,410</u>	<u>51,201,211</u>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar në emër të menaxhmentit më 19 prill 2022.


Agron Tigani
Drejtor Ekzekutiv


Rasim Maloku
Drejtor Financiar


Kastriot Zhaveli
Kontabilist i certifikuar



Shënimet shoqëruese prej faqes 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Euro)

		<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
	Shënimi		
Të hyrat nga shërbimet		3,965,884	3,795,599
Të hyrat tjera		1,281,766	1,194,293
Gjithsej të hyrat	12	<u>5,247,650</u>	<u>4,989,892</u>
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	13	(1,911,164)	(1,673,180)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	14	(921,251)	(770,079)
Shpenzimet e shpërndarjes	15	(312,444)	(628,441)
Shpenzimet e zhvlerësimit	4	(1,623,073)	(1,590,925)
Gjithsej shpenzimet		<u>(4,767,931)</u>	<u>(4,662,625)</u>
Fitimi para tatimit		<u>479,719</u>	<u>327,267</u>
Shpenzimi i tatimit në fitim	16	-	-
Fitimi neto		<u>479,719</u>	<u>327,267</u>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse		<u>479,719</u>	<u>327,267</u>

Shënimet shoqëruese prej faqes 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021
(Shumat në Euro)

	Kapitali aksionar	Rezervat tjera	Humbja e bartur	Gjithsej
Balanca me 1 janar 2020	25,000	21,744,554	(1,123,212)	20,646,342
Fitimi i vitit	-	-	327,267	327,267
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	327,267	327,267
Korrigjim	-	-	-	-
Balanca me 31 dhjetor 2020	25,000	21,744,554	(795,945)	20,973,609
Balanca me 1 janar 2021	25,000	21,744,554	(795,945)	20,973,609
Fitimi i vitit	-	-	479,719	479,719
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	479,719	479,719
Korrigjim	-	-	(32,726)	(32,726)
Balanca me 31 dhjetor 2021	25,000	21,744,554	(348,952)	21,420,602

Shënimet shoqëruese prej faqes 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Shumat në Euro)

		31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
	Shënimi		
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit		479,719	327,267
<i>Korrigjimet:</i>			
Shpenzimet e zhvlerësimit	4	1,623,073	1,590,925
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues		2,102,792	1,918,192
Ndryshimi në stoqe	5	(218)	7,907
Ndryshimi në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	6	1,037,386	(732,779)
Ndryshimi në parapagimet dhe kërkesat tjera	7	(12,722)	(302,568)
Ndryshimi në të hyrat e shtyra	9	3,255,920	5,815,592
Ndryshimi në të pagueshmet tregtare dhe të tjera	10	1,199,664	258,322
Ndryshimi në detyrimet tatimore	11	(240,378)	(86,244)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		7,342,444	6,878,422
Tatimi në fitim i paguar		-	-
Flukset neto të parasë nga aktivitetet operative		7,342,444	6,878,422
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve të qëndrueshme		(6,156,175)	(8,573,394)
Shitje e aktiveve të qëndrueshme		-	-
Flukset e parasë të gjeneruara nga aktivitetet investuese	4	(6,156,175)	(8,573,394)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Korrigjim		(32,726)	-
Flukset e parasë të gjeneruara nga aktivitetet financuese		(32,726)	-
Rënia neto në mjetet monetare në arkë dhe në bankë		1,153,543	(1,694,972)
Mjete monetare në arkë dhe në bankë në fillim të periudhës		6,061,074	7,756,046
Mjete monetare në arkë dhe në bankë në fund të periudhës	8	7,214,617	6,061,074

Shënimet shoqëruese prej faqes 5 deri 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informata mbi kompaninë

KRU Hidrodrini Sh.A. ("Shoqëria") është themeluar si shoqëri aksionare me 01.06.2007 në Kosovë, sipas projektit për Korporatizimin e Sektorit të Ujit në Kosovë, me numër të biznesit 70433918, numër fiskal 600198867, dhe me numër unik identifikues 811336975. Shoqëria operon në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-016 për "Shoqëritë Tregtare", dhe Ligjit Nr. 04/L-026 për "Markat tregtare", siç është ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 05/L-040.

Shoqëria ka adresë operimi në Pejë, Lekë Dukagjini nr.156.

Shoqëria ka 1 (një) aksionar: Qeverinë e Republikës së Kosovës, që zotëron 100 % të aksioneve.

Aktiviteti primar i shoqërisë është grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë. Ndërsa aktiviteti sekondar është testi i shpuarjes dhe shpuarja.

KRU Hidrodrini Sh.A. ka 5 pika operuese:

KRU Hidrodrini Sh.A. Junik;

KRU Hidrodrini Sh.A. Pejë;

KRU Hidrodrini Sh.A. Deçan;

KRU Hidrodrini Sh.A. Istog; dhe

KRU Hidrodrini Sh.A. Klinë.

Më 31 dhjetor 2021 kompania kishte 230 punonjës (31 dhjetor 2020: 235 punonjës).

2. Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të cilat janë në aplikim në Kosovë me aprovimin nga KKRF.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

3.1 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur me parimin e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në EURO, e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

3.2 Prona, Ndërtesa dhe pajisjet

Ndërtesat dhe pajisjet janë të mbajtura në pasqyrat e pozicionit financiar në vlerën e tyre të kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje nga dëmtimi, nëse ka ndonjë (referojuni te shënimi Nr.4). Kosto përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurisë. Zhvlerësimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të jetëgjatësisës vlerësuar të secilës pasuri duke përdorur metodën lineare.

Normat e zhvlerësimit të mëposhtme zbatohen për periudhat aktuale dhe krahasuese:

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**3.2 Prona, Ndërtesa dhe pajisjet (vazhdim)**

	2021	2020
Toka	0 %	0 %
Ndërtesa	5 %	5 %
Rrjeti i ujësjellësit dhe instalimet teknike	20 %	20 %
Pajisjet, makineritë, veturat, IT, etj.	20 %	20 %
Investimet në vijim	0 %	0 %

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.3 Tatimi në fitim

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji Nr. 05/L-29 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

Shpenzimet e tatimit për periudhën përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohura direkt në kapital ose në të hyra tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i shtyrë pasuri njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme.

Tatimi i shtyrë pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që ajo nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Ngarkesa aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjeve tatimore në fuqi ose në datën e raportimit. Menaxhmenti periodikisht vlerëson qëndrimet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e zbatueshme tatimore janë subjekt i interpretimit. Ajo përcakton provizione kur është e nevojshme në bazë të shumave që pritet të paguhet në organet tatimore.

3.4 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe në llogaritë operative në bankë me afat maturimi tre muaj ose më pak.

3.5 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare dhe shumat e tjera të pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar nëse i është faturuar kompanisë apo jo.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur kontrolli i mallrave është transferuar, mallrat janë dorëzuar në vendndodhjen specifike të klientit. Një llogari e arkëtueshme njihet nga kompania kur mallrat janë dorëzuar pasi që kjo paraqet kohën në të cilën e drejta për shqyrtim bëhet e pakushtëzuar, pasi vetëm kalimi i kohës kërkohet para pagesës.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto e kthimit të konsumatorëve, zbritjet dhe tatimet e lidhura me shitje.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.6 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- (i) kompania ka transferuar te blerësit rreziqet e rëndësishme dhe përfitimet e pronësisë së mallrave;
- (ii) kompania nuk e ruan as përfshirjen e vazhdueshme menaxheriale në nivelin që zakonisht lidhet me pronësinë dhe as kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura;
- (iii) është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin të rrjedhin tek entiteti; dhe
- (iv) shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten e besueshmëri.

3.7 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e kryerjes së transaksioneve. Në çdo datë të bilancit, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo monetarë që maten në termat e kostos historike në monedhë të huaj

nuk konvertohen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën lindin.

3.8 Rënia në vlerë

Vlera kontabël e pasurive të kompanisë, me përjashtim të stoqeve rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet kur vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Për një pasuri që nuk gjeneron rrjedha hyrëse të parasë të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përkasin pasuritë.

Në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet, një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme.

3.9 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit në bilancat e bankave të njohura në fitim ose humbje. Të hyrat nga interesi njihen si akruale, duke përdorur metodën efektive të interesit. Shpenzimet e interesit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të interesit.

3.10 Përfitimet e punonjësve

Kompania nuk ndan asnjë provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve më të madha se kontributet e paguara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.11 Kontigjencat dhe provizionet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveq nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.11 Kontigjencat dhe provizionet (vazhdim)

Pasuria kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Provizioni është njohur nëse kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin; dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

3.12 Parimi i vazhdimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vazhdimësisë, e cila supozon realizimin e pasurive dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.

3.13 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim që ka ndikim të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare. Supozimet kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kyçe të vlerësimit të pasigurisë në datën e raportimit, që rrezikojnë të shkaktojnë një rregullim material në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, janë diskutuar më poshtë:

Detyrimi aktual tatimor

Pasqyrat financiare të kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 i nënshtrohen inspektimit nga autoritetet tatimore vendore, ku menaxhmenti i kompanisë ka përdorur vlerësimin dhe gjykimin e tij më të mirë, për të qenë në përputhje me ligjet tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykimin për të përmbushur kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimi tatimor më 31 dhjetor 2021 mund të ndryshojë në krahasim me atë të raportuar në këto pasqyra financiare.

Provizioni për dëmtim të llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve

Në rrjedhën normale të biznesit, kompania bën vlerësim për rikuperimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve. Faktorët dhe rrethanat e shqyrtuara nga menaxhmenti me datën e raportimit nuk rezultojnë në provizionim të llogarive të arkëtueshme.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Euro)

4. Toka, prona dhe pajisjet

	Toka	Ndërtesat	Rrjeti i Ujës-jellësit dhe instalimet teknike	Pajisjet, makineritë, veturat, IT, etj.	Investimet në vijim	Gjithsej
<i>Kosto historike</i>						
Më 1 janar 2020	2,304,250	6,238,245	24,068,144	1,994,086	7,749,634	42,354,359
Shtesat	-	29,935	122,614	32,493	8,382,807	8,567,849
Heqjet	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	2,304,250	6,268,180	24,190,758	2,026,579	16,132,441	50,922,208
Shtesat	-	99,774	83,552	70,211	5,902,639	6,156,175
Korrigjim	-	-	(2,787)	2,787	-	-
Më 31 dhjetor 2021	2,304,250	6,367,954	24,271,524	2,099,576	22,035,080	57,078,383
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>						
Më 1 janar 2020	-	(2,578,492)	(13,387,147)	(1,574,348)	-	(17,539,987)
Shtesat	-	(320,333)	(920,231)	(350,361)	-	(1,590,925)
Heqjet	-	-	-	5,544	-	5,544
Më 31 dhjetor 2020	-	(2,898,825)	(14,307,378)	(1,919,165)	-	(19,125,368)
Shtesat	-	(317,003)	(1,188,090)	(117,980)	-	(1,623,073)
Heqjet	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	-	(3,215,828)	(15,495,468)	(2,037,145)	-	(20,748,441)
<i>Vlera neto në libra</i>						
Si më 31 dhjetor 2020	2,304,250	3,369,355	9,883,380	107,414	16,132,441	31,796,840
Si më 31 dhjetor 2021	2,304,250	3,152,126	8,776,056	62,432	22,035,080	36,329,942

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Shumat në Euro)

5. Stoqet

Stoqet janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Depo Pejë	418,003	411,518
Depo Istog	49,524	50,644
Depo Klinë	14,265	16,720
Depo Junik	3,366	4,035
Depo Deçan	24,650	26,683
Gjithsej	509,808	509,590

6. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kërkesat bruto	17,921,360	18,858,021
Lejimi për borxhin e keq	(6,549,973)	(6,443,159)
Të arkëtueshmet neto	11,371,387	12,414,862
Të arkëtueshmet tjera	122,366	116,277
Gjithsej të arkëtueshmet tjera	122,366	116,277
Gjithsej të arkëtueshmet	11,493,753	12,531,139

7. Parapagimet dhe kërkesat tjera

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Tvsh e zbritshme	199,464	258,081
Parapagimet e furnitorëve	70,393	6,798
Parapagimi i tatimit në fitim	30,054	22,500
Akontacionet ndaj punëtorëve	5,501	5,501
Kërkesat nga institucionet financiare	6,283	6,466
Parapagimi i sigurimit të automjeteve	3,110	3,040
Parapagimi i pagave	486	181
Gjithsej	315,290	302,567

8. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor 2021 janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paraja në bankë	7,214,570	6,061,074
Paraja në arkë	46	-
Gjithsej	7,214,616	6,061,074

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Shumat në Euro)

9. Të hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra janë të përbëra si në vijim:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të hyrat e shtyra KFW	19,046,268	15,799,888
Të hyrat e shtyra CDS Zvicër	597,209	551,421
Të hyrat e shtyra MZHE	1,131,919	1,142,843
Të hyrat e shtyra Komuniteti	17,609	18,743
Të hyrat e shtyra USAID	1,747,771	1,869,500
Të hyrat e shtyra KK Pejë	3,084,975	2,902,686
Të hyrat e shtyra Klinë	1,405,506	1,490,256
Të hyrat e shtyra MMPH	3,800,000	3,800,000
Gjithsej	30,831,257	27,575,337

10. Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera përbëhen nga si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të pagueshmet tregtare	1,549,938	360,431
Të pagueshmet tjera	17,974	4,800
Detyrimet tjera afatshkurtëra	9,467	12,241
Pagat e pagueshme	-	243
Gjithsej	1,577,379	377,715

11. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore si më 31 dhjetor 2021 ishin:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrimi për tvsh	2,008,736	2,247,508
Detyrimi për kontributin pensional	15,591	16,264
Detyrimi për tatimin në paga	9,845	10,778
Gjithsej	2,034,172	2,274,550

12. Të hyrat nga shërbimet dhe të hyrat tjera

Të hyrat nga shërbimet dhe të hyrat tjera si më 31 dhjetor 2021 ishin:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të hyrat nga shërbimet	3,965,884	3,795,599
Gjithsej të hyrat nga shërbimet	3,965,884	3,795,599
Të hyrat për asetet e zhvlerësuara nga grantet	883,143	898,690
Të hyrat nga borxhi i keq	337,839	235,110
Të hyrat tjera	60,785	60,493
Gjithsej të hyrat tjera	1,281,766	1,194,293
Gjithsej të hyrat	5,247,650	4,989,892

KRU Hidrodrini Sh.A.Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Shumat në Euro)**13. Shpenzimet e personelit**

Shpenzimet e personelit përbëhen nga si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga dhe mëditje	1,751,056	1,593,596
Kontributet pensionale nga punëdhënësi	87,681	79,584
Kontributet shëndetsore	72,428	-
Gjithsej	1,911,164	1,673,180

14. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative përbëhen nga si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzimet e energjisë elektrike	530,310	510,559
Shpenzimet e borxheve të këqija dhe dyshimta	234,301	95,171
Shpenzimet e jashtme profesionale dhe udhëtimet zyrtare	45,781	55,541
Shpenzimet e analizave të ujit dhe klorit	33,208	26,360
Shpenzimet e licencimit	21,454	-
Shpenzimet e zyrës	8,596	22,074
Shpenzimet materiale dhe administrative	-	21,641
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	19,737	18,403
Shpenzimet e ngrohjes, mbeturinave dhe rrjetit të ujit	5,407	6,918
Shpenzimet e donacioneve	40	4,623
Shpenzimet e provizionit bankar	4,189	4,369
Shpenzimet e përfaqësimit	4,820	4,046
Shpenzimet komunale	12,907	374
Shpenzimet e gjobave	500	-
Gjithsej	921,251	770,079

15. Shpenzimet e shpërndarjes

Shpenzimet e shpërndarjes përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzimet e mirëmbajtjes/servisimit	114,326	489,123
Kosto e mallit të shitur	90,278	-
Shpenzimet tjera të shpërndarjes	25,587	64,778
Shpenzimet e karburanteve	60,343	54,242
Shpenzimet e sigurimit/regjistrimit	14,796	13,561
Shpenzimet e reklamës	5,554	5,168
Shpenzimet e qirasë	1,559	1,569
Gjithsej	312,444	628,441

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Euro)

16. Shpenzimi i tatimit në fitim	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	479,719	327,267
<i>Korrigjime për:</i>		
Shpenzimet e pazbritshme	-	-
Humbja e bartur	(795,945)	(1,123,212)
Humbja bazë për tatim	(316,226)	(795,945)
Tatimi 10 %	-	-

Tatimi në fitim në Kosovë është në normën prej 10 % në vitin 2021 (2020: 10 %) të ardhurave të tatueshme.

17. Zotimet dhe kontingjentet**(i) Zotimet**

Kompania për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 nuk kishte zotime apo detyrime kontigjente.

(ii) Kontestet

Me 31 dhjetor 2021, kompania nuk është e përfshirë në asnjë çështje gjyqësore nga aktiviteti i biznesit.

18. Instrumentet financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut**Vlera e drejtë**

Kompania ka pasuri financiare të cilat përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj. Kompania ka detyrime financiare të cilat përbëhen nga akrualet, kreditë dhe të pagueshmet e tjera. Vlerat e drejta të këtyre instrumenteve financiare nuk janë materialisht të ndryshme nga vlera e tyre e deklaruar për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër ose kushteve të tjera.

Menaxhimi i rrezikut

Kompania ka ekspozim ndaj këtyre risqeve të cilat lindin nga instrumentet financiare në posedim:

(i) *Rreziku kreditor*

(ii) *Rreziku i likuiditetit*

(iii) *Rreziku i tregut*

(i) Rreziku kreditor

Instrumentet financiare të cilat potencialisht e ekspozojnë kompaninë ndaj përqendrimeve të rrezikut kreditor përbëhen kryesisht nga balancat e të arkëtueshmeve dhe parave të gatshme. Ekspozimi i kompanisë ndaj rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Kompania ka krijuar një politikë kreditore nën të cilën secili klient i ri analizohet individualisht për besueshmëri para se termet dhe kushtet e pagesës dhe të dërgesës të ofrohen. Rreziku kreditor i të arkëtueshmeve kontrollonhet me anë të aprovimeve të arkëtueshmeve dhe shpenzimeve buxhetore që i gjenerojnë të arkëtueshmet e tilla.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Shumat në Euro)

18. Instrumentet financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)
(i) Rreziku kreditor (vazhdim)

Si me 31 dhjetor 2021 të arkëtueshmet dhe lejimet për borxhet e këqija janë të rëna në vlerë si vijon:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Të arkëtueshmet bruto	17,921,360	18,858,021
Lejimi për borxhet e këqija	(6,549,973)	(6,443,159)
Të arkëtueshmet neto	11,371,387	12,414,862

Menaxhmenti krijon lejime për rëniet në vlerë të të arkëtueshmeve të cilat përfaqësojnë vlerësimin e tij për humbjet e ndodhura në lidhje me të arkëtueshmet. Si me 31 dhjetor 2021 menaxhmenti vlerëson që të arkëtueshmet nuk janë të rëna në vlerë.

Rreziku kreditor në paratë e gatshme kontrollohet duke investuar në bankat me reputacion në Kosovë.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe ato të Kosovës

Kriza e vazhdueshme botërore financiare dhe kriza ekonomike ka rezultuar në, ndër të tjera, një nivel më të ulët të financimit të tregut të kapitaleve, nivele më të ulëta të likuiditetit në sektorin bankar, dhe kohë pas kohe, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri më të lartë në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet globale financiare kanë rezultuar edhe në dështime të bankave dhe shpëtime të bankave në të gjithë botën. Shtrirja e plotë e ndikimit të krizës financiare së vazhdueshme po dëshmon të jetë e pamundur për t'u parashikuar ose për t'u mbrojtur plotësisht nga ajo.

(ii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi i përgjithshëm i aktiviteteve të kompanisë dhe menaxhimi i pozicioneve. Përfshinë edhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të financuar pasurinë me maturitet dhe norma të përshtatshme dhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet. Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza mujore me qëllim që të menaxhojë obligimet e saj kur ato vijnë për t'u përmbushur. Maturiteti kontraktual i instrumenteve financiare të kompanisë me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 është si në vijim:

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Euro)

18. Instrumentet financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

(ii) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2021	Më pak se një muaj	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja në dorë dhe në bankë	7,214,616	-	-	7,214,616
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	11,493,753	-	-	11,493,753
Gjithsej pasuritë	18,708,369	-	-	18,708,369
Detyrimet				
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	1,577,379	-	-	1,577,379
Gjithsej detyrimet	1,577,379	-	-	1,577,379
Pozita e likuiditetit	17,130,991	-	-	17,130,991
Hendeku i likuiditetit	17,130,991	17,130,991	17,130,991	
31 dhjetor 2020	Më pak se një muaj	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja në dorë dhe në bankë	6,061,074	-	-	6,061,074
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	12,531,139	-	-	12,531,139
Gjithsej pasuritë	18,592,213	-	-	18,592,213
Detyrimet				
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	377,715	-	-	377,715
Gjithsej detyrimet	377,715	-	-	377,715
Pozita e likuiditetit	18,214,498	-	-	18,214,498
Hendeku i likuiditetit	18,214,498	18,214,498	18,214,498	

(iii) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi i çmimeve të tregut: si kursi i këmbimit të valutave, norma e interesit apo çmimi i aksioneve do të ndikojë në të hyrat dhe instrumentet financiare të mbajtura nga kompania. Objektiva e menaxhimit të rrezikut është që të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, dhe duke optimizuar kthimet.

KRU Hidrodrini Sh.A.

Shënime në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Shumat në Euro)

18. Instrumentet financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i riskut (vazhdim)

(iii) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutave të huaja pasi që shumica e fondeve pranohen dhe shpenzohen në euro. Kompania nuk përdor instrumente derivative për të shmangur ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të huaj.

Rreziku i normës së interesit

Të ardhurat e kompanisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Instrumentet financiare të kompanisë që bartin interes janë kreditë. Instrumentet në posedim të kompanisë janë me norma fikse të interesit andaj kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

19. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen si të lidhura nëse njëra palë e ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me kompaninë.

Në palët e lidhura përfshihen anëtarët e bordit dhe personeli kyç në menaxhimin e kompanisë.

Në 2021 kompania ka pasur këto transaksione me personelin kyç:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Anëtarët e bordit	23,091	36,785
Pagat e menaxhmentit	31,268	24,493

20. Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpalesje në pasqyrat e veçanta financiare.

Menaxhmenti ka analizuar dhe vlerësuar se nuk do të ketë ndikime madhore nga kriza e shkaktuar nga Covid 19, dhe nuk e ka parë të nevojshme të marrë ndonjë veprim pasi që vleresojnë që do të ketë vazhdueshmëri të aktivitetit të paefektuar nga kriza si në furnizim, shitje dhe mbledhje të llogarive të arkëtueshme dhe poashtu edhe shlyerje të detyrimeve.